

VENDIM
Nr. 166, datë 20.3.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT WBIF NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (PËRFITUESI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA
E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW),
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “TRANSPORTI I GJELBËR I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit WBIF ndërmjet Republikës së Shqipërisë (përfituesi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e projektit “Transporti i gjelbër i Tiranës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJA E GRANTIT

DATË 28 DHJETOR 2023

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“PËRFITUESI”), PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW, FRANKFURT AM MAIN
 (“KfW”), PËR 31,200,000.00 EURO
- TRANSPORTI I GJELBËR I TIRANËS -
GRANTI I WBIF-së – NR. WB-IG08-ALB-ENE-05

PËRMBAJTJA

Neni

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
 2. Kalimi i Grantit në Agjencinë e Ekzekutimit të Projekteve
 3. Disbursimi
 4. Pezullimi i Disbursimeve dhe Ripagimi
 5. Kostot dhe Tarifat Publike
 6. Deklaratat Kontraktuale dhe Prokura
 7. Projekti
 8. Publikimi dhe Transferimi i Informacionit lidhur me Projektin
 9. Dispozita të ndryshme
- Zotimet e Pajtueshmërisë

Bazuar te kushtet e përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (“EWBJF”), të datës [7 nëntor 2006], i ndryshuar herë pas here, dhe te formulari i aplikimit për grant për përzierjen e granteve të investimit për sektorin publik, të datës 24 maj 2023, miratuar nga komiteti drejtues përkatës më 30 qershor 2023 (“GAF”) (referuar bashkërisht si dokumentacioni i Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (“WBIF”) ose “Dokumentacioni i WBIF-së”), duke pranuar se respektimi i të drejtave të njeriut dhe respektimi i legjislacionit mjedisor të zbatueshëm, duke përfshirë marrëveshjet mjedisore

shumëpalëshe, si dhe standardet themelore të punës, të dakorduara ndërkombëtarisht, përbëjnë një element thelbësor të kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me marrëveshjen e huas në vlerën e 50,000,000.00 eurove, të lidhur më ose rreth datës së përcaktuar, ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit për financimin e zbatimit të një sistemi transporti publik të shpejtë, duke përdorur autobusë elektrikë me bateri në Tiranë (“**Projekti**”) (BMZ nr. 2019 68 361) (“**Marrëveshja e Huas**”), Përfituesi dhe KfW-ja nënshkruajnë marrëveshjen e grantit (“**Marrëveshja**”), sa më poshtë:

1. Shuma dhe Qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant deri në shumën 31,200,000.00 euro (me fjalë: Tridhjetë e një milionë e dyqind mijë euro) (“**Granti**”).

Ky Grant nuk është i ripagueshëm, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Përfituesi i kanalizon Grantin në tërësi Bashkisë së Tiranës, duke vepruar si agjenci e ekzekutimit të projekteve (“Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve”), në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2.1. Marrësi siguron që Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve të përdorë Grantin ekskluzivisht për futjen e një sistemi të tranzitit të shpejtë të autobusëve bazuar në autobusë elektrikë me bateri në Tiranë (“**Projekti**”), dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor. Detajet e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti do të përcaktohen nga një marrëveshje e veçantë, e cila do të nënshkruhet nga Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve dhe KfW (“**Marrëveshje e veçantë**”), dhe do të nënshkruhet, siç lexohet dhe pranohet nga Marrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Përfituesi ose Bashkia e Tiranës, si edhe tarifat e importit, nuk financohen nga Granti.

1.4 KfW-ja mund të zbrësë nga Granti çdo kosto të hasur si pasojë e normave negative të interesit të ngarkuar ndaj llogarisë përkatëse të Projektit sa u përket fondeve të marra prej WBIF-së për qëllime të Projektit.

2. Kalimi i Grantit në Agjencinë e Ekzekutimit të Projekteve

2.1 Marrësi i kalon Grantin Agjencisë së Ekzekutimit të Projekteve si një grant jo të ripagueshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë kalimi.

2.2 Përpara lëvrimit të parë nga Granti, Marrësi i jep KfW një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kalimi i Grantit nuk përbën asnjë përgjegjësi të Agjencisë së Ekzekutimit të Projekteve ndaj KfW për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin në përputhje me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve. Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve, dhe KfW-ja përcaktojnë në Marrëveshjen e Veçantë hollësitë e procedurës së disbursimit dhe, në veçanti, evidencat që vërtetojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

3.2 Sipas nenit 4, KfW-ja ka si detyrim të vetëm të bëjë disbursime, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje për sa kohë dhe në masën që:

a) KfW-ja i ka marrë fondet përkatëse prej EWBIF-së sipas dokumentacionit të WBIF-së;

b) KfW-ja dhe Përfituesi kanë nënshkruar Marrëveshjen e Huas, që krijon detyrime ligjore, të vlefshme, shtrënguese dhe të zbatueshme dhe është në fuqi dhe me efekt të plotë; dhe

c) KfW-ja dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve kanë nënshkruar Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të nënshkruhet pas leximit dhe dakordimit edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

d) është plotësuar kushti i përcaktuar sipas nenit 2.2.

3.3 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë t’i bëjë disbursimet pas datës 30 dhjetor 2029.

4. Pezullimi i Disbursimeve dhe Ripagimi

4.1 KfW-ja nuk mund t’i pezullojë disbursimet, përveçse kur:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas ose të marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje ose me Marrëveshjen e Huas, nuk janë përmbushur;

c) Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve nuk mund të provojë se shumata e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e përcaktuar dhe në përputhje me dokumentacionin e WBIF-së;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) disbursimet ndaj KfW-së janë pezulluar plotësisht ose pjesërisht bazuar te dokumentacioni i WBIF-së, duke përfshirë rastin kur ky pezullim nevojitet si pasojë e rrethanave të jashtëzakonshme, në veçanti: i. kur është miratuar një vendim i caktuar i BE-së ose WBIF-së që identifikon një shkelje të të drejtave të njeriut; dhe/ose ii. në raste si krizat, që shkaktojnë ndryshime të politikave të BE-së ose WBIF-së;

f) Dokumentacioni i WBIF-së resht së qeni i vlefshëm, i efektshëm, i zbatueshëm, pezullohet ose shfuqizohet ose WBIF-ja apo përfaqësuesit e WBIF-së (BEI dhe BERZH) ose Komisioni Evropian lëshojnë një urdhër rikuperimi ndaj KfW-së;

g) ndodh një ngjarje që i jep të drejtën KfW-së ta zgjidhë Marrëveshjen e Huas, ose të pezullojë disbursimet sipas Marrëveshjes së Huas; ose

h) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme, që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 4.1 b), c), d), e), f) ose g) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja mund;

a) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 b), d), e) ose g), të kërkojë ripagim të menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 c), të kërkojë ripagimin e menjëhershëm të këtyre shumave, kur Përfituesi nuk arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar dhe në përputhje me dokumentacionin e WBIF-së;

c) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 f), të kërkojë ripagimin e menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara, të cilat Përfituesi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve nuk i kanë shfrytëzuar apo transferuar ende *bona fide* te një përfitues i ligjshëm në formë ligjrisht të detyrueshme. Nga ana tjetër, Përfituesi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve përfshijnë në të gjitha kontratat, që do të financohen apo mbështeten me fonde nga Granti, dispozita që garantojnë se fondet, që ende nuk janë shfrytëzuar apo shpenzuar *bona fide* për qëllime të Projektit, do t'i transferohen Përfituesit, në mënyrë që t'i kthehen KfW-së dhe, në fund, WBIF-së.

4.3 Komisioni Evropian dhe përfaqësuesit e WBIF-së kanë të drejtë të ndërmarrin masa rikuperimi të drejtpërdrejta ndaj Përfituesit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian dhe rregulloret përkatëse të WBIF-së, kusht ky që pranohet nga Përfituesi.

5. Kostot dhe tarifat publike

Përfituesi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë lidhur me përmbylljen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Grantit.

6. Deklaratat kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë do të përfaqësojë Përfituesin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe persona të tillë të caktuar prej tij/saj në KfW dhe të autorizuar nëpërmes modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij/saj do të përfaqësojnë Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit në të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e Projektit dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë nëse revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i Përfituesit të autorizuar në atë kohë, nuk është marrë nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat në këtë Marrëveshje, si dhe njoftimet apo deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuale në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, kryhen me shkrim dhe nuk duhet të kërkojë pëlqimin e Agjencisë së Ekzekutimit të Projekteve. Marrësi i dërgon Agjencisë së Ekzekutimit të Projekteve një kopje të kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo amendim të saj sa më shpejt që të jetë e mundur në adresën e korrespondencës, siç thuhet këtu ose në një adresë tjetër të tillë, siç është njoftuar nga Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve. Çdo njoftim ose deklaratë duhet të jetë marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës përkatëse kontraktuese ose në adresën tjetër të palës përkatëse kontraktuese siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në:

KfW
Postfach 11 11 4160046
Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Faks: +49 69 7431-2944

Për Përfituesin:

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3
Tiranë

Për Agjencinë e Ekzekutimit të Projekteve

Bashkia e Tiranës
Sheshi Skënderbeu 1001/Tiranë
Shqipëri

7. Projekti

7.1 Përfituesi do të sigurojë që Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve do të:

a) përgatitë, zbatojë, operojë dhe ruajë Projektin në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në pajtim me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në pajtim me konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Ekzekutimit të Projekteve dhe KfW-së;

b) caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit tek inxhinierë konsulentë të kualifikuar dhe të pavarur, dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) përmbushë kurdohërë dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) mbajë ose sigurojë mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta, duke treguar në mënyrë transparente të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe identifikuar qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht;

e) lejojë përfaqësuesit e KfW-së, përfaqësuesit e WBIF-së, Komisionin Evropian, Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (“OLAF”), Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe çdo organ tjetër evropian kompetent në çdo kohë që të shqyrtojnë librat dhe regjistrat në fjalë, si dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me zbatimin dhe operimin e Projektit, dhe të kryejnë vizita për Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse;

f) sigurojë për KfW-në të gjitha informacionet dhe raportet lidhur me Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, me kërkesë të KfW-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar, informacionet dhe raportet që nevojiten për përmbushjen e detyrimeve të raportimit të WBIF-së, në veçanti:

i. raportet vjetore të zbatimit, duke përfshirë një seksion narrativ dhe financiar; si dhe

ii. të dhënat përkatëse për përditësimet gjashtëmujore në sistemin informatik të menaxhimit të WBIF-së;

7.2 Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve dhe KfW përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 7.1 dhe nenin 7.3 nga Marrëveshja e Veçantë.

7.3 Marrësi duhet dhe sigurohet që Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve të:

a) të sigurojë financimin e plotë të Projektit dhe, me kërkesë, t'i japë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk paguhen nga ky Grant janë të mbuluara;

b) informojë KfW-në me nismën e vet për çdo apo të gjitha rrethanat që pengojnë, apo rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit;

c) marrë masa të efektshme dhe të përpjesshme për zbutjen e rrezikut të Praktikave të Ndalura (të përcaktuara në vijim) ose të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme lidhur me përdorimin e Grantit dhe/ose zbatimin e Projektit. Të gjitha rastet e Praktikave të Ndalura që lidhen me Grantin dhe/ose zbatimin e Projektit, si dhe masat e lidhura me to, të marra nga Përfituesi, i duhen raportuar KfW-së me përpikëri. Përfituesi dhe/ose Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve ndërmerr hapa për zgjidhjen e kontratave me kontraktorët, për të cilat është përcaktuar se këta kontraktorë janë përfshirë në Praktika të Ndalura lidhur me zbatimin e Projektit dhe merr masat e duhura për rikuperimin e Grantit ose pjesës përkatëse të keqpërdorur.

“Praktika të Ndalura” nënkuptojnë një ose më shumë nga praktikatat e mëposhtme:

i. Praktikë Kanosëse sipas përkufizimit në shtojcë (Zotimet e Pajtureshmërisë);

ii. Praktikë e Fshtetë sipas përkufizimit në shtojcë (Zotimet e Pajtureshmërisë);

iii. Praktikë Korruptive sipas përkufizimit në shtojcë (Zotimet e Pajtureshmërisë);

iv. Praktikë Mashtruese sipas përkufizimit në shtojcë (Zotimet e Pajtureshmërisë); ose

v. vjedhje që nënkupton keqpërvetësimin e një prone që i përket një pale tjetër;

d) bëjë të mundur për Komisionin Evropian dhe Gjykatën Evropiane të Audituesve, KfW-ja apo çdo përfaqësues të autorizuar të WBIF-së të shqyrtojë dokumentacionin dhe të kryejë kontrole pa paralajmërim për përdorimin e Grantit (duke përfshirë edhe procedurat e dhënies së kontratave të financuara nga Granti), në bazë të dokumenteve mbështetëse të kontabilitetit dhe çdo dokumenti tjetër të lidhur me financimin e Projektit;

e) bëjë të mundur që OLAF-i të kryejë hetime, duke përfshirë edhe kontrole dhe inspekte pa paralajmërim, në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së ndaj mashtrimit, korrupsionit dhe çdo veprimtarie tjetër të paligjshme, dhe, kur është e zbatueshme, çdo marrëveshje të bashkëpunimit administrativ të lidhur ndërmjet OLAF-it dhe organeve kundër mashtrimit të KfW-së;

f) ndërmarrë t'u sigurojë përfaqësuesve të WBIF-së, Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe agjentëve të tyre të autorizuar, me kërkesë, informacion dhe akses në çdo dokument dhe të dhëna të kompjuterizuara, lidhur me menaxhimin teknik dhe financiar të operacioneve të financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe t'u japë akses në mjediset dhe vendet ku kryhen këto operacione. Dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara mund të përfshijnë informacione që Përfituesi, i dhe/ose Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve, i konsideron si konfidenciale, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e veta të përcaktuara, ose siç rregullohet nga marrëveshja kontraktuale. Sapo t'i ofrohet Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve, apo çdo përfaqësuesi tjetër të autorizuar të WBIF-së, ky lloj informacioni trajtohet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e konfidencialitetit të BE-së. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të ruajtura në mënyrë të tillë që të mundësojnë kontrollin, Marrësi dhe/ose Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve ka detyrimin të informojë Komisionin Evropian, OLAF-in ose Gjykatën Evropiane të Audituesve për vendndodhjen e saktë të ruajtjes së tyre. Kur shihet e përshtatshme, palët mund të bien dakord të dërgojnë kopje të këtyre dokumenteve për shqyrtim dokumentacioni;

g) informojë KfW-në, Komisionin Evropian ose përfaqësuesit e WBIF-së, nëse, sa i përket zbatimit të Projektit, është konstatuar njëra nga situatat e përjashtimit të renditura në vijim, apo nëse është konstatuar mashtrim dhe/ose parregullsi. Komisioni Evropian e përdor informacionin për qëllimin e sistemit të zbulimit të hershëm dhe përjashtimit. Marrësi dhe/ose Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve informon KfW-në, Komisionin Evropian ose përfaqësuesit e WBIF-së nëse merr dijeni se informacioni i përcjellë duhet korrigjuar, përditësuar apo hequr. Marrësi dhe/ose Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve, siguron se subjekti i interesuar është informuar se

të dhënat e tij i janë përcjellë KfW-së, Komisionit Evropian ose përfaqësuesve të WBIF-së dhe se mund të hidhen në sistemin e zbulimit të hershëm dhe të përjashtimit dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian. Neni 7.1 g) zbatohet nëse Marrësi dhe/ose Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve merr dijeni se ndaj këtyre subjekteve:

i. ose personave me të drejta përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi këto subjekte është dhënë një vendim penal ose administrativ i formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizata kriminale, pastrim parash, vepra penale të lidhura me terrorizmin, punën e detyruar të fëmijës, apo trafikimin e qenieve njerëzore;

ii. ose personave me të drejta përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi këto subjekte është dhënë një vendim penal ose administrativ i formës së prerë për parregullsi që prekin interesat financiare të BE-së;

iii. është dhënë një vendim ku shpallen përgjegjës për keqpërfaqësim lidhur me ofrimin e informacionit të kërkuar si kusht për të marrë pjesë në procedurë, ose nëse nuk e ofrojnë këtë informacion;

iv. është dhënë gjykim i formës së prerë ose vendim administrativ i formës së prerë që përcakton se subjektet kanë krijuar një ent nën një juridiksion tjetër me qëllim shmangien e detyrimeve fiskale, shoqërore apo ligjore të tjera me zbatim të detyrueshëm në juridiksionin e selisë përkatëse, administratës qendrore ose vendndodhjes kryesore të biznesit; ose

v. janë krijuar me synimin e përcaktuar në pikën iv. më sipër, siç përcaktohet me gjykim të formës së prerë ose vendim administrativ të formës së prerë;

h) japë, në lidhje me pronësinë, titullin, ose të drejtat e pronësisë industriale apo intelektuale ndaj rezultateve të Projektit dhe ndaj raporteve, dokumenteve dhe materialeve të tjera të lidhura me të, dhe vepron për të siguruar se palët e treta të përfshira do t'i japin: i. KfW-së; dhe/ose ii. përfaqësuesve të WBIF-së (BERZH dhe BEI) ose, sipas rastit, kontribuesve të WBIF-së; apo iii. palëve të treta të tjera, sipas dakordimit në Marrëveshjen e Veçantë: a) të drejta pronësie, titujsh, pronësie industriale dhe intelektuale ndaj rezultateve të Projektit; ose b) të drejta për përdorimin pa pagesë të të gjitha rezultateve, raporteve, dokumenteve dhe materialeve që vijnë nga zbatimi i Projektit, cilado qoftë forma e tyre, që u nënshtrohen të drejtave të pronësisë industriale, apo intelektuale, me kusht që të mos shkelë të drejtat ekzistuese të pronësisë industriale, apo intelektuale;

i) promovojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe respektimin e legjislacionit mjedisor të zbatueshëm, duke përfshirë marrëveshjet mjedisore shumëpalëshe, si dhe standardet themelore të punës të dakorduara ndërkombëtarisht; dhe

j) pranojë dhe njohë publikisht faktin që këto veprimtari janë financuar me burimet e WBIF-së dhe do të sigurojë zbatimin e udhëzimeve të WBIF-së, lidhur me komunikimin dhe vizibilitetin, bashkëngjitur si shtojcë ndaj Marrëveshjes së Veçantë të referuar në nenin 7.2, dhe do të sigurojë që edhe homologët kontraktualë të drejtpërdrejtë do t'i respektojnë këto udhëzime për komunikimin dhe vizibilitetin dhe se do të pranojnë dhe njohin publikisht gjithmonë faktin që veprimtaritë janë financuar me burimet e WBIF-së.

8. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Projektin

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuar në rang ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post*) për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me Projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim referuar si **“Periudha e Plotë”**).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Bërja publike e informacionit (qoftë nga KfW-ja, apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion

kontraktual, ose informacion të hollësishëm, delikat financiar, apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Projekt ose në financimin e tij, si:

- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategji biznesi;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme;
- d) të dhëna personale të personave fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

- a) Degët e KfW-së;
- b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet kompetente;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh gjerman, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizata ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) palët e kushteve të përgjithshme të EWBJF-së;
- f) institucionet administruese të EWBJF-së dhe kontribuesit e WBIF-së;
- g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij; dhe
- h) Bashkia e Tiranës.

8.3 Gjithashtu, KfW-së i është kërkuar të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit përgjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, që botojnë artikuj që kanë lidhje me qëllimin:

- a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës Ndërkombëtare të Transparencës së Ndihmës (<https://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen-fakten/internationale-transparenzstandards-59280>);
- b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<https://www.gtai.de/gtai-de/trade>);
- c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);
- d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);
- e) palët e kushteve të përgjithshme të EWBJF-së;
- f) institucionet administruese të EWBJF-së; dhe
- g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë te palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit delikat, të përmendur në nenin 8.1, që përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Përfituesi merr përsipër të respektojë në çdo kohë të gjitha detyrimet e parashikuara në Shtojcë (*Zotimet e Pajtueshmërisë*) dhe ndërmerr të sigurojë se Agjencia e Ekzekutimit të Projekteve do të respektojë në çdo kohë detyrimet përkatëse të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë.

9.2 Sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, fondet, pagesat, pasuritë që i nënshtrohen kësaj marrëveshjeje, të destinuara dhe adresuara Marrësit sipas qëllimit të përcaktuar në të, duke përfshirë këtu por pa u kufizuar në, të gjitha të mirat materiale dhe jomateriale që rrjedhin prej tyre, nuk janë subjekt i konfiskimit, ngrirjes së dënimit, apo ndonjë forme tjetër paraburgimi si pasojë e një veprimi të zbatimit të ligjit kundër Marrësit, ose që rezultojnë nga masa të tjera gjyqësore në favor të palëve të treta. Në të njëjtën kohë, Marrësi nuk mund të privohet nga pagesa apo kontributet nga KfW-ja, si rezultat i procedurave të konfiskimit, ngrirjes së urdhrit apo një urdhër zbatimi nga një gjykatë shqiptare pa një hetim të plotë dhe një seancë të qenësishme të Marrësit përpara një gjykate shqiptare dhe një vendimi përfundimtar që po merret nga kjo e fundit, i cili ka marrë në konsideratë të gjitha burimet ligjore.

9.3 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.4 Përfituesi nuk mund të caktojë ose transferojë, garantojë ose hipotekojë asnjë kërkesë nga kjo Marrëveshje.

9.5 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.6 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit, të përcaktuara në këtë Marrëveshje, përfundojnë me përfundimin e jetëgjatësisë së dobishme të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

9.7 Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi dhe nuk ka efekt derisa Përfituesi të informojë KfW-në me shkrim se procedurat e brendshme ligjore që duhen kryer nga Përfituesi kanë përfunduar (data e marrjes në KfW). KfW-ja duhet të njoftojë Marrësin në formë të shkruar rreth datës së marrjes së këtij njoftimi. Në rast se Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi pas gjashtë muajsh pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ose pas kalimit të afateve të tjera të rëna dakord nga KfW-ja, deri në datën e hyrjes në fuqi, KfW-ja do të ketë të drejtën të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga kjo Marrëveshje dhe të përfundojë pezullimin e saj duke i dërguar Përfituesit një njoftim me shkrim.

E hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën angleze.

Republika e Shqipërisë,
përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

[nënshkrimi]

Emri: Ervin Mete

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

28 dhjetor 2023

[vendi, data]

KfW

[nënshkrimi]

[nënshkrimi]

Emri: Arne Gooss

Emri: Brit Horschke

Titulli: Head of Division

Titulli: KfW Country Director

Frankfurt am Main, [data] 28 dhjetor 2023

SHTOJCË ZOTIMET E PAJTUESHMËRISË

1. PËRKUFIZIMET

“Praktikë Kanosëse”, dëmtimi apo lëndimi, ose kërcënimimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi.

“Praktikë e Fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë Korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

“Praktikë Mashtruese”, çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

“Lista e BE-së”, lista e BE-së e juridiksioneve tatimore jobashkëpunuese, siç përcaktohet dhe përditësohet herë pas here nga Komisioni i BE-së, duke përfshirë shtojcën I dhe shtojcën II të lidhur (për detaje të mëtejshme ju lutemi shikoni: <https://www.consilium.europa.eu/de/policies/eu-list-of-non-cooperative-jurisdictions>).

Shtojca I përfshin juridiksionet që klasifikohen si jobashkëpunuese dhe shtojca II përfshin juridiksione të mëtejshme (“Annexe II Jurisdictions” ose “Jurisdictions Committed Jurisdictions”), që kanë marrë angazhime të mjaftueshme për të trajtuar mangësitë e tyre të identifikuara dhe si të tilla nuk janë konsideruar si jobashkëpunuese për momentin.

Praktikë Penguese: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një Praktikë Korruptive, mashtruese, kanosëse ose të fshehtë, ose kërcënimimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë, në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një Praktike Korruptive, mashtruese, kanosëse ose të fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pathemeluar.

“Praktikë e Sanksionueshme”, çdo Praktikë Kanosëse, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese ose Praktikë Penguese (siç janë përcaktuar në këtë Marrëveshje), e cila: i. është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; dhe ii. ka ose mund të ketë një efekt material ligjor ose reputacional në Marrëveshjen ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

“Sanksione”, ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare (duke përfshirë mallrat, teknologjitë apo shërbimet dhe ndihmën financiare në lidhje me to), të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

“Organ Sanksionues”, cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e Sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

2. NDËRMARRJA E INFORMACIONIT

Përfituesi, do të:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me njohjen e klientit, apo informacione të ngjashme për Përfituesin;

b) i ofron KfW-së sipas kërkesës të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Projektin të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktore apo palëve të tjera përkatëse, të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Përfituesin, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e tij sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktore apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave për Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj Shtojce.

f) të informojë KfW, menjëherë dhe për marrëveshjen e vet, në rast se Marrësi ka ndërmend të caktojë fondet e dhëna nga KfW për (nën)kontraktimin dhe/ose palët e tjera të lidhura, të cilat ndodhen dhe/ose regjistrohen në çdo vend të listuar në jurisidiksione jobashkëpunuese si të shtojcës I të listës së BE-së; dhe

g) të informojë KfW, menjëherë dhe për vetë marrëveshjen e saj, sapo të marrë dijeni ose dyshon për ndonjë Praktikë të Shmangies Tatimore lidhur me Projektin.

3. DEKLARIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman, apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, Përfituesi siguron dhe garanton se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, apo financim të terrorizmit ose ndonjë praktikë shmangie nga taksat.

3.2 Deklarimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen si të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim të terrorizmit, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje me dokumente për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi ndërmerr:

a) të sigurojë që në lidhje me Projektin aktivitetet e tij nuk do të lindin asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit;

b) të mos hyjë në ndonjë transaksion ose të angazhohet drejtpërdrejt ose tërthorazi në ndonjë veprimtari tjetër në lidhje me Projektin që do të përbënte shkelje të sanksioneve; dhe

c) të mos ndajë fondet e dhëna nga KfW për asnjë person të vendosur dhe/ose të regjistruar në ndonjë juridiksion të mbajtur në shtojcën I të listës së BE-së pa pëlqimin paraprak të KfW-së dhe nuk do të angazhohet në asnjë aktivitet tjetër që do të përbënte një Praktikë të Shmangies Tatimore.